

VENDIM
Nr. 185, datë 2.4.2014

PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË REALIZIMIT TË KONTROLLIT MJEKËSOR
BAZË PËR SHTETASIT E MOSHËS MBI 35 VJEÇ

(Ndryshuar me VKM nr. 721, datë 12.10.2016; nr. 628, datë 30.7.2026)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 12 të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontrolli mjekësor bazë është një program kombëtar që synon depistimin e popullatës për faktorët e rrezikut dhe sëmundjet prevalente me qëllim kujdesin për shëndetin, parandalimin e sëmundjeve dhe komplikacioneve, zbulimin e hershëm të çrregullimeve, mjekimin në fazat e hershme dhe përmirësimin e kulturës shëndetësore.

2. Të gjithë shtetasit e grupmoshës mbi 35 vjeç, me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë pa pagesë nga programi kombëtar i kontrollit mjekësor bazë. Identifikimi i shtetasve të grupmoshës mbi 35 vjeç me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë realizohet nga të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të regjistrit elektronik, që administrohet nga mjekët e përgjithshëm të qendrave shëndetësore.

3. Paketa e kontrollit mjekësor bazë përfshin këta komponentë:

a) Vlerësim, këshillim, trajtim dhe ndjekje për faktorët e stilit të jetesës:

i) Puna që kryen apo ka kryer;

ii) Ushqyerja;

iii) Konsumimi i duhanit;

iv) Konsumimi i alkoolit;

v) Niveli i stresit dhe depresionit.

b) Matje, vlerësim, këshillim, referim dhe ndjekje e parametrave fiziologjikë:

i) Tensioni arterial;

ii) Peshë trupore;

iii) Aktiviteti i zemrës.

c) Matje, vlerësim, këshillim, trajtim, referim dhe ndjekje e parametrave biokimikë:

i) Formula e gjakut;

ii) Hb, HCT, MCV, MCH, MCHC;

iii) Kolesterol total, HDL kolesterol, LDL kolesterol, trigliceride;

iv) Glicemia;

v) Feçe për gjak okult;

vi) Albuminuria, prania e qelizave, cilindrave, kristaleve në urinë;

vii) urea;

viii) kreatinina.

vii) Bilirubinë totale dhe direkte, transaminaza (SGPT, SGOT).

4. Ministria e Shëndetësisë harton protokollin e realizimit të çdo komponenti të paketës së

kontrollit mjekësor bazë dhe udhëzuesin e kriterëve e të lëvizjes së shtetasve në sistemin shëndetësor për përfitimin e këtij kontrolli.

5. Ministria e Shëndetësisë miraton institucionet shëndetësore ku do të realizohen pjesë të ndryshme të paketës së kontrollit mjekësor bazë, duke garantuar mbulesën e plotë të grupmoshës së përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, bazuar në popullsinë e zonës së mbulimit, distancat e infrastrukturën, si dhe disponueshmërinë e shpërndarjen e personelit mjekësor e atij mbështetës.

6. Mjeku i familjes/qendra shëndetësore pranë të cilit janë regjistruar shtetasit që përfitojnë të drejtën për kontroll mjekësor bazë sipas këtij vendimi, njofton shtetasit për kryerjen e këtij kontrolli periodik vjetor, sipas një grafiku të bazuar në muajin e lindjes.

7. *Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratë për financimin e shërbimit të kontrollit mjekësor bazë me shoqërinë aksionare shtetërore, që ofron këtë shërbim, pas përfundimit të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat nr. 3082/20, datë 7.1.2015, “Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grup-moshat 40–65 vjeç”, të ndryshuar. Kontrata duhet të rregullojë e të përcaktojë, në mënyrë të hollësishme, formën e dhënies së këtij shërbimi dhe mënyrën e pagesës së tij.*

8. Informacioni i gjeneruar nga programi i kontrollit mjekësor bazë, bazuar në formularin përkatës, i cili miratohet me urdhër të ministrit të Shëndetësisë, përbën Regjistrin Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, të vendosur në Institutin e Shëndetit Publik. Mënyra e grumbullimit, përpunimit, analizës dhe diseminimit, si dhe aksesit në të dhënat e Regjistrit të Kontrollit Mjekësor Bazë përcaktohen me udhëzim të ministrit të Shëndetësisë.

9. Programi i kontrollit mjekësor bazë fillon të zbatohet brenda vitit 2014.

10. Ministria e Shëndetësisë përcakton mesazhin, mjetet e identifikimit, planin, kanalet e komunikimit, shtrirjen dhe kohëzgjatjen e fushatës së informimit dhe komunikimit për pjesëmarrjen e popullatës në programin e kontrollit mjekësor bazë.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Fondin e Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor.

12. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama